



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE

Nr. _____ Prot

Elbasan, më ____ / ____ / 2026

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

[Data] 15.04.2026

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik (OE) : “AD OIL” SHPK me nipt L43611201A, me
adrese: Fshati Paperr sallak, Elbasan**

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur mbi kufirin e larte monetar– Marrëveshje Kuadër.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-76543-02-18-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Loti I “Blerje gazoil d1” 36.975.000** (tridhjet e gjashte milion e nentëqind e shtatedhjet e pese mije) **lekë pa tvsh ose 383,558.091 €** (treqind e tetëdhjete e tre mije e peseqind e pesëdhjete e tete pike nentëdhjete e nje) euro pa TVSH

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:18.02.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Buletini Nr. 16 datë 23 Shkurt 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. AD OIL SHPK me nipt L43611201A

Vlera e ofruar e marzhit të fitimit në vlerë absolute është 27,00 lekë/litër dhe me fondin e marrëveshjes kuadër prej **36.975.000** (tridhjet e gjashte milion e nenteqind e shtatedhjet e pese mije) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. EUROPETROL DURRES ALBANIA me nipt K24010212N

Vlera e ofruar e marzhit të fitimit në vlerë absolute është 16,00 lekë/litër dhe me fondin e marrëveshjes kuadër prej **36.975.000** (tridhjet e gjashte milion e nenteqind e shtatedhjet e pese mije) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. EUROPETROL DURRES ALBANIA me nipt K24010212N

1. Në përmbushje te kriterit 2.3.1:Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) **Ne rastin e përvijës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara,

Në dokumentacionin bashkangjitur u konstatua se keni ngarkuar një kontratë publike vlera e të cilës është më e vogël se kërkesa e përcaktuar në kriterin më lartë. Theksojmë gjithashtu se ky dokument (kontratë dhe vërtetimi I realizimit) nuk I plotëson të gjitha elementet e përcaktuar në kriter në përputhje me përcaktimet e nenit 40, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021, i ndryshuar.

2. Në përmbushje te kriterit 2.3.2 Liçencë për tregtimin e karburanteve/lëndëve djegëse lëshuar nga pushteti vendor për të gjitha pikat e stacioneve të kërkuara

Në dokumentacionin bashkangjitur nuk keni paraqitur licencën përkatëse leshuar nga organi i pushtetit vendor, në rastin konkret nga Bashkia Elbasan, për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit me pakicë të karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) në zbatim të ligjit si mëposhtë.

Në nenin 11 të ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, i ndryshuar përcaktohet:

Personat juridikë, që i nështrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon:

- a) rafineri naftë, që ushtrojnë veprimtari të përpunimit të naftës bruto;
- b) naftësjellës e gazsjellës, që ushtrojnë veprimtarinë e transportimit të naftës bruto dhe të gazit natyror (kategoria O);
- b/1) impiante të përpunimit;
- c) shoqëritë e tregtimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit me shumicë të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre dhe lëndëve që shërbejnë si lëndë djegëse;
- ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve, gazit të lëngshëm dhe vajrave lubrifikante për automjete;**
- d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

Ne nenin 15, pika te ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet:

1. Veprimtaria e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante, ku përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, kryhet nga stacionet e shitjes së karburanteve. Me përjashtim të nënproduktit të kategorisë IV/A, nënproduktet e tjera tregtohen vetëm nëpërmjet aparateve të matjes dhe të regjistrimit të sasisë së shitjes. Stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikante ndalohen të mbushin bombola me gaz të lëngshëm për përdorim shtëpiak apo tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve janë persona juridikë, që themelohen në një nga format e shoqërive të parashikuara nga legjislacioni tregtar.

Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me Licencën përkatëse, sipas këtij ligji, me kusht që ndërtimi i instalimeve dhe funksionimi i tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë të jenë në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga ministria.

Ne nenin 20 te ligjit Nr.8450, datë 24.2.1999 “PËR PËRPUNIMIN, TRANSPORTIMIN DHE TREGTIMIN E NAFTËS, TË GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, i ndryshuar percaktohet:

1. Licencat u jepen personave juridikë, të parashikuar në pikat “ç” dhe “d”, të nenit 11 të këtij ligji, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregtimin e karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës dhe vajrave lubrifikante për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse).

2. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje.

3. Licencat për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e stacionit të karburanteve të ndërtuara në autostrada, jepen nga ministri përgjegjës për transportin, për një periudhë deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

4. Kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve përcaktohen nga Këshilli i Ministrave

3. Në përmbushje të kriterit 2.3.3 Të ketë në pronësi ose me qera 3(tre) pika karburanti, te cilat duhet te kene detyrimisht vendodhje si me poshte:

1 pike brenda qytetit te Elbasanit;

1 pike ne aksin Elbasan- Librazhd apo Elbasan-Cerrik, perfshire degëzimet ;

1 pike ne aksin Elbasan-Tirane apo Elbasan – Durres, perfshire degëzimet

Për të vërtetuar këtë operatori duhet të paraqesë **aktin e pronësisë ose kontratën e qerasë** shoqëruar me aktin e pronësisë të qeradhënësit.

Në dokumentacionin bashkangjitur nuk rezulton asnje dokument per kete kriter i cili nuk konsiderohet i permbushur **me kontraten e perdorimit** që keni me subjektin "Skenderi G" i cili **ju vendos në përdorim** pikat e veta të karburantit ne akset e kërkuara.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1 AD OIL" SHPK me nipt L43611201A

Vlera e ofruar e marzhit të fitimit në vlerë absolute është 27,00 lekë/litër dhe me fondin e marrëveshjes kuadër prej **36.975.000** (tridhjet e gjashte mijon e nenteqind e shtatedhjet e pese mije) **lekë pa tvsh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

konc : I.Tavanxhiu

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Drejtori i Përgjithshëm i ASHPR
Altin Cenolli